



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:185837

Datë: 27.09.2024

Numri i dokumentit: 06219057

C.nr.2856/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Njomëza Berisha, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditëses M.S. me nr. Personal nga Prizreni, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokat A.H. nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilin me autorizim e përfaqëson i autorizuari V.I.Xh. me objekt kontesti pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 1455.92 euro, jashtë seance, me datë 26.09.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses M.S. nga Prizreni, **DETYROHET** e paditura Komuna e Prizreni – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësi të kompensohet në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë:

1. Për periudhën kohore Shtator- Dhjetor 2020, në shumën prej 3.36 euro;
2. Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021, në shumën prej 171.7 euro;
3. Për periudhën kohore Janar - 30 Qershor 2022, në shumën prej 520,5 euro.

Në shumën e përgjithshme prej 695.56 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (01.09.2023), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

II. REFUZHET e pa bazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit në emër të pagesës mbi bazën e inflacionit përtej shumës së gjykuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, e në shumën prej 760.36 euro.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit - Drejtoria e Arsimit, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësit të ia paguaj shumën prej 124 euro, në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.

Ar sy e t i m

Paditësja M.S. nga Prizreni në këtë gjykatë me datë 01.09.2023, përmes të autorizuarit të saj, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizreni – Drejtoria Komunale e Arsimit, duke kërkuar nga gjykata që ta detyroi të paditurën për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, duke theksuar se paditësja është në marrëdhënie pune në SHFMU “Planjane” në fshatin Planjane KK Prizren, dhe bazuar në nenin 35 par.10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë që për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë. Shuma për kompensimin sipas inflacionit në vend për periudhën kohore për vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022, paditësit i takon shuma në lartësi prej 1455,92 euro.

Po ashtu ka theksuar se edhe pas kërkesës së vazhdueshme për këto kompensime pranë të paditurës, deri më tani nuk ka marrë përgjigje. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur kërkesën e paditësit vullnetarisht, gjykatës i ka propozuar që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarit të saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 10.11.2023, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Pretendimet e paditësit se i takon kompensimi i inflacionit është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK-ut. Paditësi ushtron padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të tyre pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Padia është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj çështja e pagës shtesë për shkak të inflacionit siç pretendojnë paditësit nuk lejohet me ligjin e punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Pretendimet e paditësit se i takon beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës të R. Kosovës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Po ashtu ka theksuar se e drejta për kompensim të inflacionit është parashkruar sipas nenit 353 të LMD-së. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar. Po ashtu e drejta për kompensim të inflacionit për vitin 2019 dhe deri me datë 25.08.2022 është parashkruar, sepse sipas nenit 353 të LMD-së kjo e drejtë është parashkruar Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe nenin 399

të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqësve të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës për paditëses e lëshuar nga Komuna e Prizreni – Drejtoria e Arsimit, këtu e paditura, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, në SHFMU “Planjane” në Planjane Prizren, si mësimdhënëse, nga kontrata e punës me nr.151/2022 të datës 21.11.2022, vërtetohet fakti se paditësi tek e paditura është në marrëdhënie pune që nga data 01.09.2016e vazhdon tutje. Bazuar në Njoftimin e MASHT gjykata vërtetoi se për vitin 2019, 2020, 2021 dhe 2022 lartësia e pagës bazë e mësimdhënësve në SHFMU është shuma prej 421 euro. Po ashtu gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2019 ka qenë 2.7%, për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që *“Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve* “ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësit i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përlllogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

- Për periudhën Shtator- Dhjetor 2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2020 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 10,10 euro ($421 * 0.2\% = 0,84 * 4 \text{ muaj} = 3.36 \text{ euro}$).
- Për periudhën Janar - Dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2021 ka

qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 171,7 euro ($421 * 3.4\% = 14,31 * 12 \text{ muaj} = 171,7 \text{ euro}$).

- Për periudhën 01.01. 2022 – 20.11. 2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2022 ka qenë 421 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 520,5 euro ($405 * 11.6\% = 48,83 * 10 \text{ muaj} = 488$). euro si dhe periudha prej 20 ditëve është ($48,83/30 = 1,62 * 20 = 32,5$). $488 + 32,5 = 520,5 \text{ euro}$

Bazuar në të lartcekurat, gjykata duke iu referuar nenit 398 të LPK-së, ku parashihet që: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata konstaton se me paraqitjen e padisë, në gjykatë më datë 01.09.2023 në kuptim të nenit 369 të LMD-së, është ndërprerë parashkrimi për periudhën 01.09.2020 e deri më 20.11.2022, në bazë të nenit 342 të LMD-së, parashihet që *“Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër”*. Duke u bazuar në dispozitat e lartcekura gjykata konstaton se padia e paditësit për periudhën 01.09.2020 e deri më 20.11.2022, nuk është parashkruar pasi që nuk është arritur afati i paraparë me neni 87 të LP-së.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe atë në kuptim të nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së, ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*, pasi që gjykata e vlerësoi të bazuar pretendimin e palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së palës paditëse. Kështu, sipas nenit 87 të LP-së shprehimisht theksohet që *“të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Në këtë drejtim, paditësi padinë pranë kësaj gjykate e ka parashtruar më datë 01.09.2023. Rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditësit iu ka parashkruar pjesa e kërkesës nga data 01.01.2019 deri më datë 31.08.2020. Më konkretisht, sipas llogaritjes së gjykatës, një kërkesë e tillë është parashkruar për 8 muaj ndërsa paditësi e ka ndërprerë rrjedhjen e parashkrimit dhe e ka ruajtur të drejtën për të kërkuar realizimin e kërkesës së tij në procedurë gjyqësore nga data e paraqitjes së padisë respektivisht nga data 01.09.2023, në bazë të lartcekurave. Në anën tjetër sa i përket lartësisë së pagës bazë të paditësit me të cilën është përlllogaritur shkalla e inflacionit për periudhën kontestuese, Gjykata vendosi si në dispozitiv bazuar në njoftimin e Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Inovacionit të datës 11.12.2023, të lëshuar nga vet MASHT, nga ku vërtetohet fakti se paga bazë që realizojnë mësimmësuesit në SHFMU është në lartësi prej 421euro dhe jo 744.91 sa e ka kërkuar paditësja, pasi që kjo shumë përfshinë në vete edhe shtesat në pagë që i realizon paditësi, ndërsa paga bazë e

dorëzuar si provë përmes listës së pagave në lartësi prej 588 euro paraqet pagën bazë të mësimdhënëseve pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Paga, i publikuar në Gazetën Zyrtare me datë 05.01.2023. Andaj mbi këtë bazë gjykata refuzoi të pabazuar kërkesën e paditësit sikurse në pikën nën II të dispozitivit të aktgjykimit dhe atë duke e minusuar pjesën e kërkesëpadisë së parashkruar dhe shumën e kërkuar në raport me pagën që paditësi e realizon.

Andaj, mbi këtë bazë gjykata aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit sikurse në pikën nën I. të dispozitivit të aktgjykimit, ndërsa pjesën tjetër e refuzoi të pabazuar sikurse në pikën nën II. të dispozitivit të aktgjykimit.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (01.09.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 124.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe nenit 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm –Divizioni Civil
C.nr.2856/2023, datë 26.09.2024

B. Profesional
Jeton Nezaq

Gjyqtarja
Njomëza Berisha

Numri i lëndës: 2023:185837
Datë: 27.09.2024
Numri i dokumentit: 06219057

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimi pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.